



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, të premtën që shkoi, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër ku përcaktoi afate dhe udhëzime në lidhje me fazat e mbetura në gjykim.

Ekipet e Mbrojtjes do të mbyllin zyrtarisht paraqitjen e provave më së voni deri më **2 dhjetor**.

Trupi Gjykses caktoi gjithashtu **19 janarin 2026** si afat për Prokurorinë dhe Mbrojtjen për të paraqitur dosjet gjyqësore përfundimtare të tyre, dhe për Mbrojtjen e Viktimave për dorëzimin e deklaratës mbi pasojat e krimeve të pretenduara për 155 viktima pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore.

Deklaratat përmbyllëse janë planifikuar të mbahen nga **9 deri më 13 shkurt 2026**.

Pas kësaj, Trupi Gjykses do të mbyllë çështjen gjyqësore dhe do të fillojë fazën e kuvendimeve për lëshimin e aktgjykimit.

Aktgjykimi duhet të shqiptohet brenda 90 ditësh pas mbylljes së çështjes gjyqësore. Në qoftë se rrethanat kërkojnë zgjatje të mëtejshme të afatit, ai mund të zgjatet për 60 ditë shtesë.

Me afrimin e përfundimit të procedurës së paraqitjes së provave, mund të japim disa shifra mbi parimin e procesit publik.

Gjatë gjykimit, shumica e 134 dëshmitarëve që dhanë dëshmi në sallë të gjyqit, dëshmuan plotësisht ose kryesisht në seancë publike. 61 prej këtyre dëshmitarëve dhanë dëshmi pa masa mbrojtëse.

Gjithashtu, dëshmitë e dhëna në seancë private rregullisht rishikohen dhe riklasifikohen kur është e mundur dhe publikohen vazhdimisht transkriptet me më pak redaktime për të mundësuar që procesi të jetë publik dhe të mund të ndiqet nga personat e interesuar.

Deri më sot, gjykatësit kanë lëshuar 11 vendime në lidhje me publikimin e dëshmive të 19 dëshmitarëve të dhëna në seancë private.

Të gjitha dëshmitë publike të dhëna në gjykim gjenden në faqen e internetit të DHSK-së, në rubrikën e çështjes gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* dhe në arkivin e dokumentacionit gjyqësor.





Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, në lidhje me akuza për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, konferenca përgatitore për gjykimin është planifikuar të mbahet nesër, më 28 nëntor, në orën 09:30 paradite.

Si zakonisht, para planifikimit të seancës pati konsultime me të dy palët lidhur me disponueshmërinë e tyre në këtë datë. Duke qenë se të dyja palët konfirmuan disponueshmërinë dhe nuk paraqitën kundërshtime, seanca u planifikua për këtë datë.

Gjatë seancës, pritet që palët të diskutojnë aspekte sikurse statusi i hetimeve të Prokurorisë dhe të ekipeve të Mbrojtjes, statusi i nxjerrjes së provave, dhe data e mundshme e deklaratave hyrëse dhe thirrjes së dëshmitarëve të parë.

Gjithashtu shfrytëzojmë rastin që t'u japim disa fakte në përgjigje të lajmeve dhe deklaratave të kohëve të fundit në Kosovë në lidhje me të drejta të njeriut dhe mbikëqyrjes në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë.

Në bazë të Kushtetutës së Kosovës, e ndryshuar me shumicë prej dy të tretave të Kuvendit të Kosovës, është Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara, Gjykatës Pietro Spera, jo Avokati i Popullit i Kosovës, ai që ka kompetencë të garantojë që kushtet në objektin e paraburgimit të DHS-së të jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare për drejtat e njeriut.

Në nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës lexohet: “Do të emërohet një Ombudsperson **i veçantë** i Dhomave të Specializuara, me përgjegjësi **ekskluzive** për Dhomat e Specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar ...” [theksimi i shtuar]

Avokati i Popullit i DHSK-së, Gjykatës Pietro Spera, që është ekspert në fushën e drejtave të njeriut me përvojë 30-vjeçare, deri më sot ka kryer 9 inspektive të pavarura të objektit të paraburgimit, përfshirë 3 inspektive të pavarura sivjet.

Në lidhje me mbikëqyrjen e përgjithshme, Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara vepron në mënyrë të pavarur për të monitoruar, mbrojtur dhe ruajtur të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Ai mund të marrë ankesa që pretendojnë shkelje të të drejtave të njeriut dhe të kryejë hetime në lidhje me të gjitha ankesat që merr.

Duke mbajtur parasysh kompetencën ekskluzive të Avokatit të Popullit të DHSK-së në lidhje me objektin e paraburgimit të DHSK-së, vizita e fundit e Avokatit të Popullit të Kosovës disa të të paraburgosurve nuk mund të jetë zyrtare, sepse funksioni i monitorimit zyrtar kryhet nga Avokati i Popullit i DHSK-së, i emëruar në përputhje me Kushtetutën.





Kjo shpjegon gjithashtu përse të njëjtat kushte që vlejné për persona të tjerë u zbatuan edhe gjatë vizitës së Avokatit të Popullit të Kosovës. Konkretisht, sa u takon vizitave të Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, Trupi Gjykses caktoi kushte shtesë për këto vizita, si mbikëqyrje aktive, pasi u bë e ditur se duket se këta tre të paraburgosur u kanë zbuluar disa vizitorëve informacion konfidencial në lidhje me dëshmitarë në gjykimin e tyre për krime lufte.

Gjatë inspektimeve të Avokatit të Dhomave të Specializuara, çdo i paraburgosur ka të drejtë të takohet personalisht me Avokatin e Popullit të DHSK-së, në qoftë se dëshiron, për të diskutuar çfarëdo aspekti.

Krahas monitorimit të pavarur nga Avokati i Popullit të Dhomave të Specializuara, objekti i paraburgimit i DHSK-së është gjithashtu objekt i monitorimit të rregullt nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, praktikë kjo që zbatohet që nga krijimi i Dhomave të Specializuara.

Së fundi, në lidhje me kushtet e vizitave në objektin e paraburgimit të DHSK-së, është me rëndësi të theksohet se të gjithë të paraburgosurit vazhdojnë të kenë rregullisht vizita familjare me bashkëshortet dhe fëmijët, të cilat mbahen jashtë rrezes së shikimit dhe dëgjimit të oficerëve të paraburgimit. Të gjithë të paraburgosurit kanë 10 ditë vizitash personale në çdo periudhë prej 30 ditësh, krahas thirrjeve telefonike dhe letërkëmbimeve të rregullta gjatë tërë muajit.

